

K Ë R K E S A T

PER PARAQITJE DOKUMENTACIONI PËR PERZGJEDHJEN E MBIKQYRËSVE TE PUNIMEVE TE NDËRTIMIT

1. Autoriteti Kontraktor gjate vitit 2011 me fondet ne dispozicion, do të realizoje ndertimin dhe rikonstrukcionin e objekteve te infastruktues mbrojtje, kullim, ujitje në rrethe të ndryshme të vendit.

2. Autoriteti Kontraktor kërkon nga personat e interesuar për mbikqyrjen e punimeve të ndërtimit, te cilët jane te përfshire në listën e publikuar ne faqen elektronike te Ministrise se Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, të paraqesin dokumentacionin e mëposhtem :

- Një dokument që vërteton se (subjekti juaj) nuk është në proces falimentimi, lëshuar nga Qendra Kombetare te Regjistrimit.
- Licencën për ushtrimin e aktivitetit për “Mbikqyrje të punimeve të ndërtimit (Supervizion).
- Curriculum vitae, përshkrimi i aktivitetit dhe eksperiencës së subjektit. Formular i nënshkruar nga kandidati. (Kontrata te realizuara).
- Deklarate per stafin kompetent teknik, te nevojshem si edhe per sektoret ndihmes, si mekanik, elektrik, topografik, mjedisor, etj.

3. Kandidatët e interesuar mund te kërkojnë sqarime pranë Grupit te Punes, prane Ministrise se Bujqesise, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit.

4. Dokumentacioni i mësipërm duhet të mbyllet në nje zarf ku të shënohet adresa e plotë e kandidatit dhe numri i telefonit. Afati i fundit per dorezimine dokumentacionit perkates eshte **data 04.05.2011.**

5. Dokumentacioni do të shqyrtohet nga Grupi i Punes, i cili do të përzgjedhë mbikqyrësit e punimeve te ndërtimit. Mbikqyrësit e punimeve të ndërtimit të përzgjedhur do të njoftohen zyrtarisht nga Autoriteti Kontraktor.

Pas marrjes së njoftimit kandidatët e përzgjedhur duhet të konfirmojne, nëpërmjet nënshkrimit të një deklarate, gadishmerinë për të lidhur kontratën për objektin që do të caktohet nga Autoriteti Kontraktor.

Pagesat për mbikqyrësit e punimeve të ndërtimit do të bëhen sipas tarifave përkatëse në fuqi.

6. Dokumentet duhet të jene origjinale ose kopje të noterizuara.

7. Autoriteti Kontraktor mund të kërkojë sqarime dhe dokumenta te tjera nga kandidatet për dokumentat e paraqitura.